

AGBES KONSTRUKSION SHPK

(Nipt) K32807432W

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE

INDUSTRIA MINERARE

ID 3.7 Nxjertja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret;

ID 3.1/e Përzierjen e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhim i blloqeve të betonit dhe produkteve të çimentos;

ID 3.10 Prodhimi I produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jometalike.

VENDI I USHTRIMIT TE AKTIVITETIT:

Në afërsi të Qafës së Gjoksit, 1 km larg fshatit Konizbaltë, Gja Vajgurore, Berat.



1. PROFILI I OPERATORIT DHE PROJEKTI

Shoqëria **AGBES KONSTRUKSION SH.P.K.** është regjistruar pranë QKB me Nr.NIPT **K32807432W**.

Kompania jonë është e pajisur me 3 leje mjedisore si më poshtë vijon:

LEJA MJEDSIORE TIPI B	AKTIVITETI
PN-3518-05-2012 Nr.3393 Prot, Nr.2140 Identifikimi Datë 25.05.2016 .	ID 3.7 Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret.
PN-3582-08-2016 Nr.5302 Prot, Nr.2274 Identifikimi Datë 15.08.2016 .	ID 3.1/e Përzierjen e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhim i blloqeve të betonit dhe produkteve të çimentos. ID 3.10 Prodhimi I produkteve abrazive dhe produkteve te tjera minerale jometalike.

Të gjitha këto aktivitete për të cilat jemi pajisur me leje mjedisore tipi B me PN-3518-05-2012 dhe PN-3582-08-2016 ushtrohen në po të njëjtën vendndodhje: **Në afërsi të Qafës së Gjoksit, 1 km larg fshatit Konizbaltë, Ura Vajgurore, Berat.**


Duke qene se të dyja këto aktivitete zhvillohen në të njëjtin vend për të cilin ne kemi leje të shfrytëzimit mineral, sipërfaqen e së cilës e mbulon leja mjedisore me **PN-3518-05-2012**, po fillojmë procedurën për ndryshim të kushteve të lejes me **PN-3518-05-2012**, në mënyrë që tek kjo leje të përfshihen edhe aktivitetet që zhvillohen tek lejet me **PN-3582-08-2016**.



2. VENDNDODHJA E USHTRIMIT TE AKTIVITETIT

Aktiviteti do të zhvillohet në **Qafa e Gjoksit, 1 km larg fshatit Konizbaltë, Bashkia Ura Vajguore.**

X	Y
4402980	4513340
4402740	4512790
4402600	4512860
4402700	4513380



3. PROCESI TEKNOLOGJIK

ID 3.7 Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret


Përshkrim i veprimtarisë së specifikuar
<p>Kompania Agbes Konstruksion Sh.p.k. zotëron një leje minerale që nga viti 2003 dhe në vitin 2013 ajo bëri rinovimin e lejes deri në vitin 2023. Shfrytëzimi i karrierës bëhet duke filluar nga hapja e rrugëve të aksesit për të bërë kapjen e niveleve të sipërme të saj. Rrugët e aksesit hapen duke përdorur Buldozera, eskavatora me çekiç hidraulik dhe në disa raste duke përdorur dhe mina. Materiali i gërmuar në këtë proces përdoret për nivelimin e rrugës dhe kur ai del i pastër përdoret për rehabilitimin e skarpateve dhe shesheve, të cilat janë shfrytëzuar në vite.</p> <p>Pas bërjes së rrugëve të aksesit bëhet pastrimi i shtresës së sipërme të shpatit nga materiali vegetativ dhe humusi dhe ky material transportohet për tu përdorur për rehabilitim.</p> <p>Me anë të kompresorit dhe sondës në faqen e shpatit bëhen vrima në distancë të caktuara që varen nga fortësia e shkëmbit në thellësi 10-12 m. Në këto vrima vendosen kapsollat elektrike dhe mbushen me lëndë plasëse. Shpërthimi i këtyre minave bëhet i kontrolluar me leje nga autoritetet lokale të rendit dhe pasi bëhet boshatisja e territorit nga çdo gjë e gjallë, e cila mund të lëndohet.</p> <p>Pas thërrmimit të gurit gëlqeror me mina ose në raste kur nevojitet, pas minave përdoren dhe çekiç pneumatic për të bërë thërrmimin e gurëve, të cilat kanë ngelur më të mëdhenj se 500 mm.</p> <p>Materiali i përftuar nga thërrmimi me mina apo me çekiç quhet çakull minash dhe pasi ngarkohet me eskavator, me zinxhirë transportohet me kamiona të mëdhenj për në fronto.</p> <p>Frontoja është pajisje me një shoshë vibruese dhe me një mulli me nofulla, e cila pasi e ndan materialin nga dheu e thyen atë deri në fraksione 100-200 mm, për ta depozituar në sheshin e magazinimit.</p> <p>Nga ky shesh me anë të fadromës materiali ngarkohet në kamiona me kapacitet 12 -20 m³ për tu dërguar në impiantet e thyerje-fraksionimit për tu kthyer në granile dhe rërë.</p>



ID 3.1/e Përzierjen e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhim i blloqeve të betonit dhe produkteve të çimentos

ID 3.10 Prodhimi I produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jometalike

Përshkrim i veprimtarisë së specifikuar	
<p>Materiali i nxjerre nga karriera sipërfaqeore e gurit gelqeror me ane të kamionave transportohet për derdhur në bunkier. Nga ky bunkier me ane të transportierit me rripa materiali bie në siten vibruese e cila me ane të vibrimit bënë fraksionimin e materialit nga papastertite. Papastertite me ane të një transportieri nxirren jashtë perpunimit dhe duke pasur parasysh se këto papasterti janë dhëra dhe humbje përdoren për reabilitim. Materiali i pastër nga sita vidruese bie në një mulliri me nofulla (primar) i cili bënë thyerjen e gurit deri në dimensione 60 deri në 100 mm. Materiali me dimensione 60 deri në 100 mm i prodhuar nga mulliri me nofulla (primar) me ane të një transportieri me rripa dërgohet në një mulliri me përplasje (sekondar) i cili bënë thyerjen e materialit në fraksione me të vogla. Materiali i përfutur me ane të një transportieri me rripa dërgohet në një sete sitash vibruese nga e cila materiali me dimensione me të mëdha se 30 mm rikthehet me ane të një transportieri me rripa në mullirin me përplasje (sekondar) për të rithyer ndërsa pjesa tjetër vidrohet për të përfutur:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. granil me dimensione 20 mm. 2. granil me dimensione 10 mm. 3. rere me dimensione 5 mm. <p>Te gjitha inertet e prodhuara me sipër me ane të transportierve me rripa dërgohen në përgjithësi të mëdha në fushë. Nga këto përgjithësi krijuara në fushë me ane të fadromave bëhet ngarkimi në kamion me kapacitete deri në 30 ton për të transportuar në impiantet e prodhimit të asfaltit, betonit apo për të përdorur në shtresa rrugore.</p> <p>Procesi teknologjik në nyjen e fraksionimit Procesi teknologjik në impiantin e thyerjes së gurit dhe fraksionimit të subjektit 'Agbes Konstruksion' sh.p.k konsiston në marrjen e gurit gelqeror nga karriera që ndodhet aty afër, transportimin e tyre tek impianti i thyerjes dhe fraksionimit, thyerjen dhe fraksionimit sipas kërkesave teknike, dhe prodhimin e betonit për përdorimin e tyre në industrinë e ndërtimit. Qëllimi i ngritjes së këtij impianti është</p>	<p>shfrytëzimi dhe rritja e efektivitetit të përdorimit të gurit gelqeror të karrierës me qëllim përdorimin e tyre në sektorin e ndërtimit. Procesi teknologjik në impiantin e thyerjes dhe fraksionimit të gurit gelqeror realizohet përmes makinerive të përshkruara në skemë dhe që përbehet nga :</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Bunkieri për gurin gelqeror <input type="checkbox"/> Transportieret <input type="checkbox"/> Mulliri <input type="checkbox"/> Sita e mëdha dhe të vogla <input type="checkbox"/> Pedane për shpërndarje të materialit dhe transportieri <p>Materiali i marrë në karrierën e gelqeroreve, me ane të kamioneve riportabel të firmës, nga zona e shfrytëzimit transportohet dhe depozitohet pranë impiantit të thyerjes dhe fraksionimit. Për nga aty hidhet në bunker dhe i nënshtrohet procesit që thërrmë me sipër. Impianti i fraksionimit është i vendosur mbi një bazament betoni, mase kjo e marrë për të siguruar mjetet e transportit, me pas është mulliri i cili bënë thyerjen e materialit në dimensione mbi 40mm dhe larjen e tij nga papastertite, me anën e sitave pas thyerjes bëhet fraksionimi i materialit në rere me dimensione 0-4 mm, granil në 4-10 mm dhe në 10-30 mm, pastaj stabilizante 0-40 dhe makadam 0-50. Procesi i perpunimit të gurit gelqeror konsiston në marrjen e gurit nga karriera së vete subjektit që ndodhet aty afër vazhdon me transportimin e tij për tek makineritë, pastaj me thyerjen dhe fraksionimin sipas kërkesave teknike, për përdorimin e këtij materiali në dimensione të ndryshme ashtu siç e kërkon industria e ndërtimit. Vëndndodhja e impiantit është bërë në mënyrë të tillë që të jetë sa më afër karrierës së shfrytëzimit të gurit gelqeror dhe sa më afër rruges automobilistike, për të kursyer sa më shumë karburant, makineri transporti dhe kohë, për nderkohe që të mos pengojë punimet gjatë shfrytëzimit të gelqeroreve.</p>



4. NDIKIMET NEGATIVE NE MJEDIS

NDIKIME NE AJER

Aktiviteti do te shoqerohet me shkarkime ne ajer te pluhrave gjate shfrytezimit te karrieres siperfaqesore, si dhe gjate procesit te fraksionimit te inertevesi dhe te prodhimit te betonit. Subjekti do aplikojte sprucimin me uje gjate periudhave te thata, per te reduktuar shkarkimet ne ajer.

NDIKIME NE TOKE

Mjedisi tokesor mund te ndeshet gjate levizjes se makinave te tonazhit te rende, qe bejne te mundur transportin e lendeve te para dhe produktit perfundimtar. Persa i perket karrieres qe shfrytezohe subjekti ben rehabilitim here pas here sipas protokolleve.

NDIKIME NE UJERA

Uji qe perdoret per te minimizuar pluhrat gjate veres, aplikohet pa krijuar rrjedha ujore, rrjedhimisht nuk kemi gjenerim te kesaj tipologjie te ujerave. Ndersa ne prodhimin e betonit uji perdoret ne sasi te caktuara, sipas recepturave. Prandaj as nga prodhimi i betonit nuk kemi gjenerim te ujerave te ndotur. Pra zhvillimi i aktivitetit nuk shoqerohet me shkarkime ndotese ne ujera siperfaqesore, nentokesore apo kanalizime.

NDIKIME NE KLIME

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

NDIKIME NGA ZHURMAT

Zhurma do te krijohen kryesisht gjate momentit gjate procesit te shfrytezimit te karrieres dhe gjate procesit te fraksionimit te inerteve dhe prodhimit te betonit. Nuk do te shkaktohet ndotje akustike ne mjediset e banuara pasi ato ndodhen larg zones se zhvillimit te ketij aktiviteti.

NDIKIME NE POPULLESI

Realizimi i projektit nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullses se rajonit ku do zbatohet projekti. Gjate funksionimit te impiantit nuk ka emetime ne ajer, toke apo uje te cilat ndotin ambientin dhe te rrezikojne shendetin e punonjesve apo te popullses se rajonit.



NDIKIME NE FLOREN DHE FAUNEN

Zona në të cilën ushtrohet aktiviteti është një zonë pa elemente të spikatur të flores dhe faunes. Kështu që zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ndikon në flore e as faune. Subjekti do të rehabilitojë sipërfaqet që shfrytëzohen duke zbatuar planet e rehabilitimit që ka hartuar.

NDIKIMET E AKTIVITETIT TE ZHVILLIMIT MBI NDERTIMET, TRASHEGIMINE ARKITEKTONIKE HISTORIKE DHE ZONAT E MBROJTURA

Aktiviteti që ushtron shoqëria zbatohet në një zonë në sipërfaqen e së cilës dhe në nëntokën e saj nuk ka ndertime lidhur me trashëgiminë arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra të tjera njerezore. Gjithashtu zhvillohet në një llogaritje të konsiderueshme nga zonat e mbrojtura. Kjo tregon që zona është zonë e lirë jo vetëm për të realizuar këto aktivitete.

MBETJE

Mbetje të ngurta urbane - Këto mbetje gjenerohen nga punonjësit e punësuar në këto aktivitete. Ato pas çdo dite pune do të dergohen në vendin e përcaktuar nga Pushteti vendor. Pushteti vendor është përgjegjës për trajtimin e metejshëm të tyre jashtë instalimit.

Mbetje nga procesi teknologjik – Çdo mbetje nga proceset teknologjike rifutet në proces pune në impiantin e fraksionimit si dhe në impiantin e prodhimit të betonit.

AGBES KONSTRUKSION SH.P.K.

Administrator: _____

